



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS  
OSNOVNI SUD U MITROVICU - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.273/2015

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,** (e vendosur ne objektin e Degës së Kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Naim Mcholli, në çështjen juridike të paditësit: Agjencioni Pyjor të Kosovës DK në Mitrovicë të cilin e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim, kundër të paditurit nga Koshtovë Komuna e Mitrovicës, baza e kontestit: Kompensim dëmi, pas mbajtjes së seancës kryesore me datën: 01.08.2016, me datën: 12.08.2016 bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

- **OBLIGOHET,** i padituri që brenda afatit 15 ditor nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi t'ia paguaj paditësit shumën prej 787.00 euro ne emër te kompensimit të dëmi, me kamatë vjetore që paguhet në lartesine e mjeteve të deponuara ne bankat afariste pa destinim të caktuar, nga data e parashtrimit të padisë, e gjer në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.
- **OBLIGOHET,** i padituri që në emër të shpenzimeve gjyqesore, gjykatës t'ia paguaj shumën prej 30 euro ne emer te takses per padi dhe takses për përpilimin e aktgjykimit të gjitha këto në afat 15 ditor nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi me datë: 23.04.2012 ka parashtruar në gjykatë padi kundër të paditurit për kompensimin e dëmit që rrjedh nga vjedhja e pyllit.

I autorizuari i paditëses edhe në seancë kryesor edhe në fjalën perfundimtare deklaroi se i padituri nga fshati Komuna e Mitrovicës me dt: 13.08.2009 dhe 20.08.2009 ne vendin e quajtur ne pyllin ne pronesi shtetore e qe menagjohet nga AKP ka kryer vepren penale vjedhje pylli e sanksionuar me dispozitat e nenit 285 par. 1 te Kodit Penal te Kosovës, fajsjia dhe përgjegjësjia e të paditurit është vërtetuar me aktgjykim P.0021/2011 dhe P.0018/2011 te cilet jan bër te plotfuqishëm me dt: 24.11.2011, me këtë i padituri i ka shkaktuar damë ne vlerën prej 787 euro konform përlllogaritjes sipas udhëzimit administrativ nr.12/2005, ku si prov i ofroj gjyqates ekstraktin e udhëzimit në fjal i cili përcakton qmimin për

meter kub të drunjëve sipas llojit dhe trashësis, andaj duke u mbështetur në këto prova kërkojm nga gjykata që të vendos kërkespadin në tërësi si të bazuar dhe ta obligoj të paditurin që ta kompenzoj dëmin e shkaktuar si dhe shpenzimet tjera gjyqësore-procedurale.

Në seancë nuk prezentoi i padituri edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsytuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata administroi këto prova: aktgjykimi penal P.nr.0021/2011 i dt.28.09.2011 me datë të plotfuqishmerisë 24.10.2011, aktgjykimi penal P.nr.0018/2011 i dt.28.09.2011 me datë të plotfuqishmerisë 24.10.2011, udhëzimi administrativ MA-NR 12/2005.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi në pajtim me nenin 7 dhe 8 të LPK-së dhe erdhi në këto konkludime:

Faktin se i padituri i ka shkaktuar dëmin paditësit me datën 13.08.2009 dhe 20.08.2009 gjykata e vërteton në bazë të Aktgjyqimeve penal P.nr.0021/2011 i dt.28.09.2011 me datë të plotfuqishmerisë 24.10.2011, aktgjykimi penal P.nr.0018/2011 i dt.28.09.2011 me datë të plotfuqishmerisë 24.10.2011.

Kërkesa pronore juridike për dëmin e shkaktuar është llogaritur në bazë të udhëzimit administrativ MA-NR.12/2005 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës.

Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar konform dispozitave të neneve: 158 në lidhje me nenin 185, par.1, 2 dhe 4 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve ( i vjetri i aplikuar në këtë rast).

Gjykata, lidhur me caktimin e kamatës vjetore, u bazua në nenin 277, par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të aplikueshëm në rastin konkret, ndërsa, lidhur me lartësinë e saj, u bazua në lartësinë e mjeteve të deponuara në bankat afariste për një vit pa destinim të caktuar.

Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata u bazua në nenin 452 paragrafi 1 i të LPK-së, ku pala e cila e ka humb kontestin duhet t'ia paguajë palës tjetër shpenzimet procedurale.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.Nr.273/2015 datë: 12.08.2016**



**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat 7 ditor nga dita e pranimit së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – nëpërmjet kësaj gjykate.